



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 16.04.2019
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË GJYQËSORE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në mbledhjet e datës 09.04.2019, 10.04.2019 dhe 15.04.2019 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm znj.Vasilika Hysi si nismëtare e projektligjit, dy prokurorë të Prokurorisë së Përgjithshme, z.Kujtim Luli dhe z.Alfred Progonati si dhe znj.Mimoza Arbi, Drejtorishë e Shërbimit Juridik në Kuvendin e Shqipërisë.

Relatore e projektligjit ishte znj.Ermonela Felaj (Valikaj).

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji është hartuar në përputhje me nenin 81, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj ka për qëllim:

- riorganizimin strukturor dhe funksional të policisë gjyqësore, duke synuar rritjen e përgjegjësiave të saj në zhvillimin e hetimeve profesionale dhe efikase në luftën kundër kriminalitetit, nën drejtimin dhe kontrollin e prokurorit;
- qartësimin e roleve të Prokurorit dhe Policisë Gjyqësore, duke e kthyer prokurorin në një mbikqyrës të hetimit penal, dhe duke ia deleguar kompetencat e hetimit dhe një pjesë të veprimeve procedurale gjatë hetimit Policisë Gjyqësore;
- rregullimin e raportit të numrit të prokurorëve me numrin e oficerëve të Policisë Gjyqësore
- forcimin e kriterëve profesionale, etike e morale në rekrutimin dhe promovimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore, duke synuar krijimin e një sistemi që mundëson arsimim të përshtatshëm profesional, zhvillimin e një karriere të qëndrueshme si dhe trajnimin dhe kualifikimin vazhdues të tyre;
- parashikimin e mekanizmave për tërheqjen e kontributit të specialistëve dhe ekspertëve teknikë pranë zyrave të prokurorisë;
- garantimin e burimeve të nevojshme materiale, financiare dhe njerëzore për Policinë Gjyqësore, duke synuar gjithashtu thithjen e ekspertëve të fushave të ndryshme pranë kësaj strukture.

Nëpërmjet projektligjit synohet të zgjidhjen një sërë problematikash të konstatuara në organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, si :

- dobësimi i lidhjeve të oficerëve të shërbimeve, të caktuar në seksionet e prokurorive, me administratën e origjinës;
- ndryshimet në ligjit ekzistues në vitin 2010 me heqjen e procedurës së konkurrimit për oficerët e shërbimeve në seksionet e prokurorisë;
- lëvizjet dhe transferimet e shpeshta të tyre;
- mosnjohja nga prokurorët e organikave të policisë gjyqësore;
- dobësimi i bashkëpunimit midis prokurorisë dhe policisë gjyqësore;
- dhënia e detyrave me karakter administrativ punonjësve të policisë që ushtrojnë dhe funksionin e policisë gjyqësore të cilat kanë cenuar stabilitetin në punën e policisë gjyqësore si dhe vetë cilësinë e hetimeve.

Projektligji i depozituar në Kuvend, i është nënshtruar një diskutimi të gjerë dhe konsultimi me një sërë institucionesh, së pari me përfaqësues të Policisë Gjyqësore, me Prokurorinë e Përgjithshme, me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me misionin e OSBE-së në Tiranë, me misionin EURALIUS, por njëkohësisht kanë qenë edhe përfaqësues të Ministrisë së Financave pasi një nga pikat e forta dhe të debatueshme

është trajtimi financiar i oficerëve të Policisë Gjyqësore, duke pasur parasysh se me paketën e re të ligjeve të reformës në drejtësi, këta të fundit nuk kanë më mundësi të promovohen dhe të bëhen prokurorë pa përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës.

Të gjitha ndryshimet që janë bërë nga grupi i punës kanë mbajtur në konsideratë problematikat me të cilat përballet shërbimi i Policisë Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë dhe objektivat që synohen të arrihen që janë miratuar në Dokumentin Strategjik për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

Projektligji i ripunuar nga grupi i punës, përbëhet prej IX krerësh si më poshtë:

Kreu I, parashikon objektin e ligjit, cilat janë parimet e ushtrimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore dhe subjektet që ushtrojnë këto funksione.

Kreu II, parashikon varësinë dhe ushtrimin e funksioneve, duke përcaktuar qartë kush janë funksionet e policisë gjyqësore, mbikqyrjen dhe varësinë e policisë gjyqësore si dhe ruajtjen e sekretit hetimor.

Kreu III, flet për Komisionin e Policisë Gjyqësore, i cili është një organ kolegjal i përbërë nga 5 anëtare, duke përcaktuar edhe mandatin e kryetarit dhe anëtarëve të komisionit. Gjithashtu në këtë kre përcaktohen kompetencat e komisionit si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij.

Kreu IV, pasqyron organizimin e policisë gjyqësore, kush janë seksionet dhe shërbimet e policisë gjyqësore, si organizohen shërbimet dhe seksionet dhe cilat janë kriteret e përzgjedhjes së oficerëve të shërbimeve dhe atyre të seksioneve të policisë gjyqësore dhe procedura e ndjekur. Gjithashtu, ky kre përmban dispozita në lidhje me heqjen dorë, zëvendësimin, ngritjen në detyrë, komandimin, transferimin si dhe shkarkimin e lirim të tyre oficerëve të policisë gjyqësore.

Kreu V, veprimtaria hetimore e policisë gjyqësore, bën një ndarje midis veprimeve hetimore që kryhen nga shërbimet e policisë gjyqësore dhe atyre veprimeve hetimore që kryhen nga seksionet e policisë gjyqësore. Gjithashtu parashikon edhe mundësin e kryerjes së veprimeve hetimore si nga shërbimet ashtu dhe nga seksionet, kjo në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes.

Kreu VI, parashikon rregulla në lidhje me trajnimin dhe vlerësimin e rezultateve në punë.

Kreu VII, rregullon trajtimin financiar të policisë gjyqësore, duke përcaktuar pagën e tyre, shpërblimet dhe përfitime të tjera.

Kreu VIII, flet për përgjegjësinë disiplinore të oficerëve të policisë gjyqësore, duke përcaktuar cilat janë shkeljet, masat disiplinore dhe procedurën disiplinore si dhe organin kompetet që ka të drejtën e fillimit të procedimit penal duke i dhënë mundësi oficerit apo agjentit të policisë gjyqësore të mund të ankohet në Gjykatën Administrative.

Kreu IX, dispozitat kalimtare, parashikon detyrimin e Këshillit të Ministrave dhe Komisionit të Policisë Gjyqësore për të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

- ***Diskutimi në komision***

✚ Zonja Hysi, në fjalën e saj, u shpreh se projektligji i është nënshtruar një diskutimi të gjerë dhe konsultimi me një sërë institucioneve duke bërë një përmbledhje të draftit të ripunuar dhe propozuar nga grupi i ekspertëve si më poshtë:

Objektivi i parë dhe kryesor që projektligji synon, është që të riorganizojë nga pikëpamja strukturore dhe funksionale Policinë Gjyqësore. Kjo është bërë duke pasur parasysh ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, miratuar në marsin e 2017-ës. Kjo është edhe një nga arsyet se përse ky projektligj ka marrë kaq shumë kohë dhe nuk ka kaluar në vitin 2017 së bashku me paketën e ligjeve të tjera të reformës në drejtësi. Pra, duhej të miratohej Kodi i Procedurës Penale, të ngrihej Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, më pas të vazhdohej me miratimin e dy-tre ligjeve që kanë mbetur.

Në këtë kuadër, ndryshimet e sjella nga grupi i punës, kanë bërë ndryshime shumë esenciale në organizimin dhe funksionimin e organit të shërbimit të Policisë Gjyqësore. Ndryshimet kanë të bëjnë jo thjesht me emërtime, por edhe me mënyrën e organizimit e të funksionimit të policisë gjyqësore, shërbimeve dhe seksioneve.

E dyta, lidhur me organizimin dhe funksionimin ka një qartësim sa i përket varësisë së këtyre institucioneve, grupi i punës, sidomos me mendimet e sugjerimet hera-herës kontradiktore midis përfaqësuesve të Policisë së Shtetit dhe përfaqësuesve të Prokurorisë së Përgjithshme, kanë sjellë disa riformulime në lidhje me varësinë dhe ushtrimin e funksioneve të Policisë Gjyqësore, me organizimin e këtyre shërbimeve, me mënyrën e emërimit, transferimit, promovimit në karrierë të oficerëve të Policisë Gjyqësore, të shërbimeve e të seksioneve.

Komisioni i Policisë Gjyqësore është ndryshimi më i rëndësishëm që vjen në raport me nismën që e depozituar, por edhe për shkak të funksioneve shumë të rëndësishme ose të kompetencave që ky Komision i Policisë Gjyqësore ka, pasi ai emëron, ngre në detyrë, transferon dhe komandon oficerët e Policisë Gjyqësore, shqyrton kërkesat e procedimit disiplinor, bën vlerësimin e punës dhe të integritetit të tyre.

Komisioni i Policisë Gjyqësore është një organ kolegjal, i cili do të ketë një përbërje të ndryshme nga ajo e paraqitur në nismën e depozituar: pra, nga një prokuror që propozohet nga Prokurori i Përgjithshëm, nga një anëtar-oficer i Policisë Gjyqësore, i seksionit të prokurorisë, i cili përsëri propozohet nga Prokurori i Përgjithshëm, si dhe nga një anëtar nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, i cili caktohet nga

drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, një anëtar tjetër caktohet nga shërbimet e tjera, që mund të jenë Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve apo institucione të tjera, me rotacion, si dhe një anëtar që është drejtues i strukturave hetimore të Shërbimit të Policisë së Shtetit. Njëkohësisht, grupi i punës ka përcaktuar dhe sjellë kriteret që duhet të përmbushin, kushtet formalo-ligjore që duhet të përmbushin anëtarët e këtij komisioni.

Ky projektligj:

- synon të nxisë hetimet proaktive, profesionale dhe efikase, të ndërmarra nga Policia Gjyqësore, çka tregon se punonjësit e policisë, të cilët do të punojnë edhe në shërbime edhe në seksione, duhet të punësohen në bazë të një procedure transparente, publike, bazuar në profesionalizmin, në sistemin e hierarkisë së vlerave, në rritjen e tyre në karrierë, në mënyrë të vazhdueshme, në bazë të meritokracisë.
- sjell rregulla të qarta të emërimit, transferimit, promovimit në karrierë, duke vlerësuar gjithmonë burimet e brendshme, njerëzit që kanë dhënë kontribute në shërbimet apo në seksionet e Policisë Gjyqësore.
- është bërë një qartësim i rolit të prokurorit dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore. Prokurori do të jetë ai që do të ndjekë, do të mbikëqyrë hetimet, ndërsa oficerët e Policisë Gjyqësore kanë një sërë kompetencash të mirëpërcaktuara.
- përcakton kriteret të qarta për mënyrën e përzgjedhjes së oficerëve të shërbimeve dhe oficerëve të seksioneve të Policisë Gjyqësore pranë prokurorisë. Është proces i hapur dhe transparent.
- rregullon mundësinë e shmangies së konfliktit të interesit
- lidhur me përgjegjësinë disiplinore, ka një rregullim shumë të detajuar të procedurës së përgjegjësisë disiplinore të oficerëve të Policisë Gjyqësore të masave, duke bërë përshkallëzimin e tyre sipas shkallës së rëndësisë që kanë, por edhe duke ruajtur proporcionalitetin e masave disiplinore që mund të zbatohen në raport me rëndesën e shkeljeve të lehta, të rënda dhe shkelje shumë të rënda..

Në mbyllje të fjalës së saj Znj.Hysi u shpreh në lidhje me trajtimin financiar të Policisë Gjyqësore. Ajo tha se Ministria e Financave ka rekomanduar që paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve të jetë 50% e pagës së prokurorit, por oficerët e Policisë Gjyqësore dhe të Prokurorisë së Përgjithshme kanë kërkuar 70%. Grupi i punës ka sjellë një riformulim, ku në nenin 30, pagat e oficerëve të Policisë Gjyqësore të seksioneve të prokurorisë, të gjykatës së shkallës së parë, të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme e kanë të llogaritur 50% të pagës bruto fillestare të prokurorit, i cili ushtron funksionet pranë tyre, por njëkohësisht ata do të kenë edhe një shtesë prej 2% në vit pas 5 vjetësh shërbim për çdo vit vjetërsie deri në 25 vjet. Pra, është përdorur, pak a shumë, modeli i pagës së prokurorëve dhe gjyqtarëve. Është bërë një diferencim për oficerët e Policisë Gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit, të cilët do të përfitojnë një pagë shtesë deri në 10% të pagës bazë për gradën përkatëse, ndërsa për sa i përket pagë së oficerit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit ajo është 20% më e lartë se paga e oficerit të Policisë Gjyqësore të seksioneve.

✚ Relatorja e projektligjit, Znj.Felaj, në fjalën e saj u shpreh se projektligji “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” është një ndër projektligjet e paketës së reformës në drejtësi. Në draftin e depozituar janë bërë shumë ndryshime, të tilla, që e kanë ndryshuar në një masë të madhe projektligjin, duke sjellë para nesh një projekt të ri në përmbajtje. Besoj që projekti të ketë ruajtur linjat kryesore që parashikon Kodi i Procedurës Penale lidhur me funksionimin e Policisë Gjyqësore, sepse nuk mundemi që me këtë ligj, i cili miratohet me shumicë të thjeshtë në Kuvendin e Shqipërisë të dalim jashtë standardeve kryesore të funksionimit të Policisë Gjyqësore që parashikon Kodi i Procedurës Penale.

Mandej znj.Felaj shtoi se Komisioni për Sigurinë Kombëtare, ka në përbërje anëtarë, të cilët kanë pasur të bëjnë drejtpërsëdrejti me Policinë Gjyqësore, qoftë nga roli i atij që e delegon dhe e urdhëron Policinë Gjyqësore, por qoftë edhe nga drejtuesit e shërbimeve të policisë, që po ashtu edhe ato kanë të tilla raporte me shërbimet e Policisë Gjyqësore. Kështu që eksperiencia teorike, pa dyshim, është e vlefshme, por jo më pak është e vlefshme edhe ajo praktike, sepse besoj se është qartë për të gjithë që ne kemi një përvojë jo të vogël me Policinë Gjyqësore, kemi një përvojë që nga viti 1995. Ligji që ka pasur të bëjë me organizimin e kësaj strukture, në kohë të ndryshme ka pësuar ndryshime, me të cilat mund të kemi qenë ose jo dakord, por ama në fund të ditës, puna na ka bërë që të dalim në konkluzionet nëse këto ndryshime e kanë impaktuar për mirë punën e Policisë Gjyqësore, apo për keq.

Në këtë komision askush nuk e vë në dyshim se puna e Policisë Gjyqësore është zemra e hetimit, sepse shumica dërmuese e veprimeve hetimore janë veprime që kryhen nga oficerët e Policisë Gjyqësore. Kështu që ne duhet t’i japim rëndësinë që i takon kësaj strukture, ta respektojmë për punën që bën dhe ta vendosim në ato nivele që ajo të performojë sa më mirë të jetë e mundur dhe besoj se ky është momenti që e vendos këtë gjë.

Mandej Znj.Felaj shtoi se ligji duhet të jetë i qartë, duhet të jetë me një gjuhë të thjeshtë, me një gjuhë të pastër, e cila nuk lë vend për dykuptueshmëri, por qartëson saktësisht se cili do të jetë pozicioni i oficerit të Policisë Gjyqësore, cili do të jetë trajtimi financiar i tyre, cila do të jetë karriera e tyre. Në fakt, këtu do të rezervohesha ta quaja një karrierë të mirëfilltë, sepse me ndryshimet që janë bërë në Kushtetutë, oficerëve të Policisë Gjyqësore, nuk u lejohet më të bëhen prokurorë. Më parë oficerët e Policisë Gjyqësore kishin të drejtë të bëheshin prokurorë, pas një stazhi të caktuar pune, kurse tani rruga e ngritjes në karrierë është mbyllur, sepse prokuror bëhesh vetëm nëse ke mbaruar Shkollën e Magjistraturës. Sidoqoftë, në këto rrethana bëhet akoma edhe më e domosdoshme që ta shikojmë siç duhet pozitën e oficerit të Policisë Gjyqësore.

Gjithashtu, znj.Felaj shtoi se nga përvoja shpesh herë në punën e oficerit të Policisë Gjyqësore, veçanërisht atyre të ardhur nga shërbimet, ka pasur konfuzion për shkak të varësisë dyfishe. Ndërkohë që varësinë administrative vijnë ta kenë nga Policia e Shtetit, për punën hetimore varen nga prokurori. Kjo ka sjellë edhe vonesa në hetime.

Saktësimi i faktit që kemi oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve që janë juristë, se kemi oficerë të shërbimeve që janë punonjës të Policisë së Shtetit, kemi agjentë si dhe punonjës të strukturave të tjera ligjzbatuese që marrin attribute të Policisë Gjyqësore, pra kanë të drejtë të kryejnë veprime njësoj si Policia Gjyqësore, do të na ndihmojë që çdonjëri të kuptojë limitet e punës së tij dhe cilat janë prioritetet e punës së tij.

Anëtarët e Komisionit të Sigurisë u shprehën dakort në parim me projektligjin dhe vijuan diskutimet në çështjet që lidhen me trajtimin financiar të oficerëve të policisë gjyqësore duke mbështetur fort faktin se paga e tyre duhet të vijojë në raportin 70% me pagën e prokurorit, si një pagë që oficerët e policisë gjyqësore e kanë fituar me ligj dhe e marrin që nga 1 janari 2019. Në lidhje me këtë çështje, në adresë të Komisionit për Sigurinë Kombëtare ka ardhur edhe një letër nga një grup oficerësh të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë për Krimet e Rënda dhe Prokurorisë së Rrethit Tiranë, të cilët shprehen se paga në masën 70% është një e drejtë e fituar tanimë me ligj dhe nuk mund të hiqet me një ligj tjetër dhe se kjo e vë në pozita jo të barabarta me policinë gjyqësore të shërbimeve në Policinë e Shtetit. Konkretisht, referuar ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, mjafton t’i referohemi **nenit 67** “Trajtimi financiar gjatë qëndrimit në punë”, **nenit 68** “E drejta për sigurim shëndetësor të veçantë”, **nenit 69** “E drejta për përfitim kredie me interesa të buta” e në vijim, për të kuptuar se oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve kanë përfitime më të mëdha se oficerë e policisë gjyqësore të seksioneve.

Çështje të tjera që u diskutuan ishin që duhet cilësuar varësia dhe duhet të specifikohet më shumë detyrimi që kanë oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore ndaj prokurorit; se cili do të jetë raporti i komunikimit të tyre me drejtuesit e policisë, si do të rekrutohen këto shërbime; forcimin e kriterëve profesionale, etike e morale në rekrutimin dhe promovimin e oficerëve të Policisë Gjyqësore, duke synuar krijimin e një sistemi që mundëson arsimim të përshtatshëm profesional, zhvillimin e një karriere të qëndrueshme si dhe trajnimin dhe kualifikimin vazhdues të tyre; cilat do jenë institucionet përgjegjëse për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm të oficerëve të policisë gjyqësore, riorganizimin strukturor dhe funksional të policisë gjyqësore, duke synuar rritjen e përgjegjësisë së saj në zhvillimin e hetimeve profesionale dhe efikase në luftën kundër kriminalitetit, nën drejtimin dhe kontrollin e prokurorit etj.

- **Riformulime nen për nen**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare bazuar në çështjet e parashtruara si dhe nga diskutimi nen për nen i projektligjit, i sugjeron Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, si komision përgjegjës, riformulimet si më poshtë:

- **Në nenin 2 të projektligjit, pika 5 të ndryshohet si më poshtë:**

5. “Papajftueshmëria” sipas këtij ligji është situata që pengon oficerin e policisë gjyqësore të ushtrojë me objektivitet funksionet e tij në një zyrë të caktuar, për shkak të

raporteve që burojnë nga gjendja familjare, nga lidhjet e papërshtatshme shoqërore ose nga konflikti i interesit.

- Në nenin 4 të projektligjit, në gërmën “b” dhe “c”, fjala “punonjësit” të zëvendësohet respektivisht me fjalën “oficerët e shërbimeve” dhe “hetuesit”, dhe neni të riformulohet si më poshtë:

“Funksionet e policisë gjyqësore ushtrohen nga:

- a) oficerët e policisë gjyqësore në seksionet pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm,*
- b) oficerët e shërbimeve të Policisë së Shtetit, të cilët janë pjesë e strukturës hetimore,*
- c) hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kanë statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar,*
- ç) punonjësit e shërbimeve të tjera policore dhe të institucioneve shtetërore të cilëve me ligj u njihen funksionet e Policisë Gjyqësore.”*

- Në nenin 5 të projektligjit, në pikën 1, gërma “a”, fjala “nisëm” të zëvendësohet me fjalën “iniciativë”, duke u përdorur e njëjta fjalë që përdor edhe Kodi i Procedurës Penale.

- Në nenin 6, të hiqet togfjalëshi “ të institucioneve të tjera shtetërore”, dhe neni të riformulohet si më poshtë:

Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore si dhe çdo punonjës i Policisë së Shtetit, kanë të drejtë të kryejnë veprime hetimore, kur lind nevoja e ruajtjes së gjurmëve të veprës penale ose të vendngjarjes, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke njoftuar menjëherë sipas rastit shërbimin ose seksionin kompetent të policisë gjyqësore.

- Në nenin 7 të projektligjit, pika 6 të riformulohet si më poshtë:

“Policia gjyqësore zbaton udhëzimet e përgjithshme me karakter detyrues që nxjerr Prokurori i Përgjithshëm, për oficerët e policisë gjyqësore dhe për koordinimin e veprimtarisë së prokurorëve .

Ky është një ligj që rregullon organizimin dhe funksionimin e oficerëve të policisë gjyqësore. Në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme”, që është një ligj i cilësuar, është përcaktuar qartësisht se çfarë bën Prokurori i Përgjithshëm, ndaj vlersojmë që nuk është rasti të marrim një dispozitë të atij ligji dhe ta vendosim në një ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë.

- Në pikën 8 të projektligjit, në pikën 2, togfjalëshi “normat e moralit” të zëvendësohet me fjalën “liritë” dhe neni të riformulohet si më poshtë:

“2. Policisë gjyqësore i ndalohet, posaçërisht, të publikojë ose të përhapë fotot dhe gjeneralitetet e të miturve, viktimave si dhe çdo të dhënë tjetër që cënon liritë dhe të drejtat kushtetuese të personit”.

- **Në nenin 9 të projektligjit, në lidhje me pikën 3 të tij,** të gjithë anëtarët e Komisionit të Sigurisë u shprehen se **mandati 2 vjeçar** është mjaft i kufizuar dhe janë dakort që ai **të zgjatet në 4 apo 5 vjet,** kjo sipas diskrecionit të komisionit përgjegjës.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare mbështet fort propozimin e ardhur nga grupi i punës, sipas të cilit, në përbërje të Komisionit të Policisë Gjyqësore, anëtari prokuror dhe anëtari oficer i policisë gjyqësore të seksioneve të zgjidhet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe jo nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Ligji nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton qartë detyrat e Prokurorit të Përgjithshëm, konkretisht:

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së prokurorisë

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e Policisë Gjyqësore, si dhe kryen detyra të tjera të caktuara me ligj.
2. Prokuroria i ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur nëpërmjet prokurorëve.

Neni 38

Kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm

2. Prokurori i Përgjithshëm ushtron këto kompetenca:

„,,,,dh) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për oficerët e Policisë Gjyqësore, në përputhje me këtë ligj;

g) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e Policisë Gjyqësore;

gj) kërkon fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore dhe ankesa ndaj oficerëve të Policisë Gjyqësore;,,,,,,

3. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Prokurori i Përgjithshëm mund t'i delegojë me shkrim kompetenca të caktuara drejtorëve të drejtorive, drejtuesve të seksioneve ose prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas parashikimeve në këtë ligj ose në ligje të veçanta.

Neni 108

Marrëdhëniet me Policinë Gjyqësore

1. Prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të Policisë Gjyqësore, në përputhje me ligjin procedural penal dhe parashikimet e bëra në ligjin organik për Policinë Gjyqësore.
2. Urdhrat dhe udhëzimet e karakterit të përgjithshëm dhe të posaçëm që lidhen me procedimin penal janë të detyrueshme për Policinë Gjyqësore.

Nëse përgjegjësinë për Policinë Gjyqësore ia kemi lënë Prokurorit të Përgjithshëm, kuptohet se në Komisionin e Policisë Gjyqësore duhet të jetë një prokuror, i cili vjen nga Prokuroria e Përgjithshme, i caktuar nga Prokurori i Përgjithshëm, pasi nuk mund t'ia japim atij përgjegjësitë në ligj, e pastaj t'ia kërkojmë këto përgjegjësi kur ai nuk ka instrumentet për të ekzekutuar të tilla përgjegjësi në Komisionin e Policisë Gjyqësore.

- **Në nenin 13 të projektligjit, pika 3 të riformulohet** si më poshtë:

1. Seksionet e policisë gjyqësore organizohen në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Përgjithshme”.

- **Në nenin 15 të projektligjit, pika 1 e tij të riformulohet** si më poshtë:

“1. Seksionet e policisë gjyqësore organizohen në përputhje me strukturën e prokurorive të shkallës së parë, apeleve të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorinë e Përgjithshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë”.

- **Në nenin 16 të projektligjit, në pikën 1 të tij, në gërmën “c” togfjalëshi “nën procedim” të zëvendësohet** me togfjalëshin **“në hetim”**, ndërsa në gërmën **“d”** togfjalëshi **“cilësi të larta etike dhe morale”** të zëvendësohet me fjalën **“integritet”**.

- **Në nenin 17 të projektligjit, në gërmën “d” togfjalëshi “nën procedim” të zëvendësohet** me togfjalëshin **“në hetim”**, ndërsa në gërmën **“e”** togfjalëshi **“cilësi të larta etike dhe morale”** të zëvendësohet me fjalën **“integritet”**.

- **Në nenin 22 të projektligjit, në pikën 1, në gërmën “d” të hiqet fjala “etike”** ndërsa **pika 4** e këtij neni të riformulohet si më poshtë:

“4. Komisioni i Policisë Gjyqësore, pasi verifikon përmbushjen e kriterëve të paragrafit 1 të këtij neni dhe jo më vonë se 10 ditë nga marrja e propozimit, vendos mbi pranimin ose mospranimin e tij.

Kur ekziston një situatë reale rreziku ndaj jetës dhe shëndetit të punonjësit të policisë gjyqësore ose të familjarëve të tij, Komisioni i Policisë Gjyqësore vendos brenda 48 orëve nga marrja dijeni e propozimit.

Në rastet kur transferimi ndikon në ecurinë e hetimeve paraprake, Komisioni i Policisë Gjyqësore mund të vendosë shtyrjen e tij në një kohë të përshtatshme”.

- Në nenin 26 të projektligjit, togefjalëshi “ose institucionet publike arsimore” të zëvendësohet me togefjalëshin “Shkolla e Magjistraturës” dhe neni të riformulohet si më poshtë:

“Akademia e Sigurisë dhe Shkolla e Magjistraturës, në bashkëpunim me Komisionin e Policisë Gjyqësore dhe Prokurorin e Përgjithshëm kryejnë trajnimin fillestar të hetimi, sipas parashikimeve të nenit 16 dhe 17 të këtij ligji”.

- Në nenin 27 të projektligjit togefjalëshi “pranë institucioneve publike arsimore” të zëvendësohet me togefjalëshin “pranë Shkollës së Magjistraturës dhe Akademisë së Policisë” dhe neni të riformulohet si më poshtë:

“Oficerët e policisë gjyqësore i nënshtrohen trajnimit vazhdues, pranë Shkollës së Magjistraturës ose Akademisë së Sigurisë, të ngarkuara me ligj për kryerjen e trajnimit profesional”.

- Në nenin 30 të projektligjit, sugjerojmë që **paga e oficerit të policisë gjyqësore pranë prokurorive, të jetë në raportin 70% të pagës bruto fillestare të prokurorit** si një e drejtë e fituar tanimë me ligj dhe si një trajtim adekuat i policisë gjyqësore në kushtet e reja që solli zbatimi i Reformës në Drejtësi.

- Në nenin 41 të projektligjit, në pikën 3 të tij, afati **6 muor** të bëhet **3 muor**.

- **Përfundim**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- **Në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- **Në aspektin procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Kryetar / Relator

Ermonela (Felaj) VALIKAJ